



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.10.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR
MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e ekipit, Selvete Foniqi dhe Anëtarët Shefkije Beka dhe Adelina Selmani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
5 Qeverisja e mirë.....	22
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	24
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga dy vitet paraprake	27
Shtojca III: Letërkonfirmimi	31

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Megjithatë, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se furnizimet për material zgjedhor në vlerë prej 130,175€, ishin përtej vlerës dhe sasive të kontraktuara.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:**Përgjigja e Menaxhmentit**

Menaxhmenti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Ne kemi analizuar veprimtarinë e KQZ-së, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se furnizimet në vlerë prej 130,175€, për material zgjedhor ishin përtej vlerës dhe sasive të kontraktuara. Në procesin e zgjedhjeve lokale KQZ kishte porositë dhe pranuar materiale për zgjedhje më tepër se sasia e kontraktuar. Materiali ishte pranuar, mirëpo pagesa ishte refuzuar nga zyra e financave, me arsyetimin se këto porosi kanë tejkaluar

sasitë e kontraktuara. Si pasojë Operatorët Ekonomik që kanë kryer furnizimet kanë proceduar lëndët të përmbaresi me qëllim të inkasimit të mjeteve. Këto detyrime për faktin që janë bërë të kontestueshme janë prezantuar dhe shpalosur te pasqyrat financiare te neni 18 - detyrimet kontingjente.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Menaxhmenti i KQZ-së është përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetarja dhe Kryeshefi Ekzekutiv janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KQZ-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

KQZ-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore;
- Raportin e kontratave të nënshkruara; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Në kontekst të PFV-ve, përkundër korrigjimeve që i kishte bërë KQZ, kemi identifikuar disa mangësi, si në vijim:

- *Te neni 13, Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme* - vërehet se depozitat në vlerë prej 36,600€ nuk janë prezantuar te pranimet dhe pagesat tjera. Kjo shumë nuk ishte prezantuar as te neni 14 si pagesa tjera;
- *Te neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit* - vërehet se te kolona e realizimit, hyrjet si depozita ishin prezantuar gabimisht në vlerë 39,800€, derisa vlera e depozitave 73,800€, më diferencë 34,000€. Po ashtu, në tabelën e njëjtë buxheti final ishte nënvlerësuar për 1,576€;
- *Te neni 16 - Raporti për të arkëtueshmet* - vërehet se nuk janë shpalosur gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike në proceset zgjedhore në vlerë 22,653€. Llogaritë e arkëtueshme të pa shpalosura i takojnë viteve 2014–2017; dhe
- *Te neni 19 - Raporti për pasuritë jo financiare* - vërehet se pasuritë ishin të nënvlerësuar për 65,970€ si rezultat i mos regjistrimit të pasurive në regjistra kontabël.

Ndërsa, sa i përket kërkesave tjera për raportim të jashtëm, Raporti i kontratave të nënshkruara i KQZ-së për vitin 2017, i dorëzuar në KRPP nuk ishte i plotë dhe i saktë. Ne vërejtëm se tri kontrata me vlerë totale prej 13,653€ nuk ishin të përfshira në raport, si dhe një kontratë me vlerë 44,000€ ishte paraqitur gabimisht dy herë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj se është bërë një analizë detale për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, duke marrë veprime specifike për përmirësuar kontrollet në menaxhimin e kontratave. Në këtë aspekt, të ndërmerren veprimet e duhura që të forcohen kontrollet e brendshme për të parandaluar pranimet përtej vlerës dhe sasive të kontraktuara.

Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj prezantimin e drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare përfshirë depozitat, të arkëtueshmet dhe pasuritë. Gjithashtu, duhet vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar se informatat e raportuara për menaxhmentin dhe palët tjera të interesit të rishikohen në mënyrë kritike para se ato të dorëzohen, me qëllim të evitimit të gabimeve.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Realizimi i buxhetit prej 97%, paraqet performancë të mirë buxhetore. Viti 2017 ishte sfidues për faktin që ishin organizuar zgjedhjet qendrore dhe lokale në një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj. Si rezultat i aktiviteteve të shumta gjatë proceseve operative ka pasur edhe mangësi të cilat janë prezantuar në raport.

Fushat ku janë vërejtur mangësi më të theksuara janë në menaxhimin e personelit ku me aprovimin e rregullores së re të KQZ-së emërimet në pozita drejtuese ishin bërë me vendime pa ndonjë procedurë, si dhe angazhimet e stafit për zgjedhje (marrëveshje për shërbime të veçanta) në disa raste ishin bërë pa procedura të rekrutimit. Po ashtu, mangësi ishin evidentuar edhe te klasifikimi i shpenzimeve, menaxhimi i proceseve të prokurimit dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,618,324	16,483,801	16,062,781	5,369,043	5,228,119
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,618,324	16,482,224	16,062,781	5,369,043	5,228,119
Donacionet e jashtme	-	1,577	-	-	-

Me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë², buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,865,477€. Kjo rritje është rezultat i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të mbajtura me datën 11/06/2017 si dhe shuma 1,577€ ishte grant i donatorëve³.

¹ Buxheti final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF

² Me vendim të Qeverisë nr.02/145 janë shtuar mjetet në këto kategori: paga dhe mëditje-322,500€, mallra dhe shërbime 2,646,100€, shpenzime komunale 31,400€. Si dhe me rishikim buxheti nr.05-L-125 janë shtuar 1,944,900€.

Buxheti final për investime kapitale ishte reduktuar për 81,000€, për dy projektet kapitale me vendim të Qeverisë⁴. Për këto dy projekte KQZ ka bërë kërkesë me 10/07/2017 për ridestnim të mjeteve me arsyen se nuk mund të realizohen për shkak të angazhimeve në dy procese zgjedhore. Mirëpo kërkesa për ridestnim nuk është aprovuar.

Në vitin 2017, KQZ ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 16,062,781€, që paraqet një shpenzim më të ulët për 2% në raport me vitin 2016. Megjithatë, duhet theksuar se krahasimi me vitin paraprak në aspektin e përqindjes nuk na jep ndonjë informatë shumë relevante nga fakti që në vitin 2017 buxheti ishte më i madh si rezultat i organizimit të zgjedhjeve nacionale dhe lokale. Më poshtë jepen shpjegimet detaje për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,618,324	16,483,801	16,062,781	5,369,043	5,228,119
Pagat dhe Mëditjet	707,864	1,030,364	1,026,967	756,384	714,800
Mallrat dhe Shërbimet	6,436,269	11,038,608	10,689,403	381,570	285,133
Shërbimet komunale	48,391	70,028	34,900	22,644	29,513
Subvencionet dhe Transferet	4,200,000	4,200,000	4,196,859	4,198,550	4,198,673
Investimet Kapitale	225,800	144,801	114,652	9,895	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për mallra dhe shërbime është shpenzuar 96%. Pjesa e pashpenzuar prej 349,205€ ka mbetur si rezultat i kthimeve për pagesat e individëve të angazhuar në procese zgjedhore, për shkak të gabimeve në llogaritë e tyre apo edhe të dhënave tjera, dhe mjetet kanë shkuar në suficit; dhe
- Buxheti për investime kapitale ishte shpenzuar 79%. Projektet e mbetura ishin realizuar me një kosto më të ulët se sa që ishin të buxhetuara.

³ Ky ishte grant i pashpenzuar i vitit 2010 që ishte bartur nëpër vite. Ky grant ishte nga Qeveria Italiane për përkrahje në procesin zgjedhor.

⁴ Me vendim nr.01/21 të datës 22/12/2017 janë marrë mjetet e projektit "Sistemi i menaxhimit të informatave" dhe "Zhvillimi i aplikacionit online për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës".

Çështja 2 - Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve

- E gjetura** Pajisjet e TI-së të blera në shumë 24,779€ ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga investimet kapitale. Në kuadër të kësaj pagese vërehet se pajisjet e TI-së në vlerë prej 16,657€ ishin nën 1,000€. Këto pajisje do të duhej të buxhetohen dhe të paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
- Rreziku** Klasifikimi dhe pagesa e shpenzimeve nga kategoria ekonomike jo adekuate ndikon në mbivlerësimin dhe/ose nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve. Si rrjedhojë e kësaj paraqitja e tyre në pasqyra financiare nuk ishte e drejtë.
- Rekomandimi 2** Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj se buxhetimi dhe shpenzimet realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga KQZ-ja në vitin 2017 ishin 30,687€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat e transferuara nga depozitat për partitë politike që kanë humbur garën 24,600€, të hyrat nga gjobat për partitë politike 3,187€, dhe të hyrat nga regjistrimi i subjekteve politike 2,900€. Këto të hyra transferohen direkt në Buxhetin e Kosovës.

Krahasuar me vitin 2016 që ishin 2,500€, në vitin 2017 të hyrat ishin në vlerë prej 30,687€, si rezultat i zgjedhjeve të mbajtura në vitin 2017.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të KQZ-së kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Buxheti final për paga dhe mëditje, në vitin 2017 ishte 1,030,364€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,026,967€. Ato kanë të bëjnë me pagesat e anëtarëve të KQZ-së dhe stafit administrativ.

Për periudhën gjatë procesit zgjedhor është aplikuar shtesa mujore prej 60% e pagës bazë për të gjithë stafin, dhe 150€ për angazhime shtesë vetëm për shërbyes civil. Kjo shtesë është aplikuar me vendim të Qeverisë përgjatë proceseve zgjedhore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i aprovuar i të punësuarve në KQZ ishte 88, ndërsa numri aktual në fund të vitit ishte 82. Gjashtë pozitat e buxhetuara në vitin 2017 nuk ishin plotësuar.

Çështja 3 – Avancimi në pozita menaxheriale pa procedura

E gjetura KQZ për një kohë të gjatë ka mbuluar pozitat menaxheriale me ushtrues detyre duke i tejkalar afatet ligjore. Kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportet paraprake të auditimit. Me aprovimin e rregullores⁵ për organizimin e brendshëm këto pozita ishin mbuluar me pozita të rregullta.

Mangësi ishin vërejtur në procesin e avancimeve për pesë pozita menaxheriale. Këto avancime të pozitave janë bërë me vendim për transferimin e nëpunësit, duke u bazuar në rregulloren e brendshme 04/2017. Megjithëse, ato nuk ishin transfere mirëpo ishin avancime për pozita menaxheriale, të cilat nuk janë në përputhje me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civilë. Kjo rregullore kërkon që paraprakisht njësia e personelit të zhvillojë procedurat e avancimit. KQZ nuk kishte shpallur ndonjë konkurs për avancim në karrierë.

Rreziku Avancimet në pozita menaxheriale pa zhvillim të procedurave, rrisin rrezikun e kufizimit të konkurrencës, duke bërë avancime që e cenojnë parimin e transparencës dhe meritës dhe si pasojë angazhimet e tilla mund të mos jenë në përputhje me nevojat e KQZ-së.

Rekomandimi 3 Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj që avancimet në pozita menaxheriale të bëhen me konkurs të brendshëm siç e parashohin procedurat e avancimit në përputhje me rregulloren Nr.21/2012.

⁵ Rregullorja nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në sekretariatit e komisionit qendror të zgjedhjeve.

Çështja 4 - Përzgjedhja e stafit për shërbime të veçanta pa procedura konkurruese

- E gjetura** KQZ kishte angazhuar staf për zgjedhjet e jashtëzakonshme në qershor 2017. Për shkak të afateve të kufizuara për angazhimin e tyre në procesin zgjedhor dhe në pamundësi për të zhvilluar procedura të thjeshtësuara të rekrutimit, KQZ si praktikë aplikon angazhimin e kandidatëve nga lista e zgjedhjeve paraprake.
- Ligji për Shërbimin Civil, në nenin 12 kërkon që për kontrata për shërbime të veçanta të zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Nga 14 kontratat e testuara për shërbime të veçanta të vitit 2017, vërejtëm se në nëntë raste (që nuk ishin marrë nga lista e zgjedhjeve paraprake) nuk kishte dëshmi se si ishin përzgjedhur.
- Rreziku** Marrëveshja për shërbime të veçanta pa procedura të thjeshtësuara të rekrutimit kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që angazhimi i stafit të bëhet në mënyrë jo transparente dhe si pasojë shërbimet e pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat e KQZ-së.
- Rekomandimi 4** Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj se për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta janë zhvilluar procedura të përzgjedhjes së tyre, në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe të kenë mundësi të aplikojnë të gjithë ata që i plotësojnë kriteret.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra e shërbime dhe komunalit në vitin 2017 ishte 11,108,637€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 10,724,302€. Pjesa më e madhe ka të bëjë për staf të angazhuar në procese zgjedhore në shumë 8,674,818€, furnizime për zyrë, telefoni mobile.

Numri i të angazhuarve në procese zgjedhore për vitin 2017 arrin në 958 individë. Ky numër përfshinë stafin jopermanent të angazhuar me kontratë për shërbime të veçanta, komisioner dhe trajner.

Çështja 5 - Përbërja e komisionit të vlerësimit jo konform rregullës së prokurimit

- E gjetura** Në udhëzuesin operativ të prokurimit publik të ndarja e detyrave në pikën 62.3 specifikohet qartë se një zyrtar i cili ka përgatitur specifikimet teknike për një tender nuk mund të jetë anëtar i komisionit të vlerësimit. Te prokurimi “Furnizim me kompjuterë për ZLKZ” në komisionin e vlerësimit kishte marrë pjesë një zyrtarë, i cili kishte përgatitur specifikat e kompjuterëve.
- Rreziku** Emërimi në procesin e vlerësimit të zyrtarëve që kanë përgatitur specifikat teknike përveç që është në kundërshtim me parimet e ndarjes së detyrave e rrezikon edhe objektivitetin e vlerësimit të tenderit nga ana e komisionit. Krejt kjo mund të ndikoj edhe në përzgjedhjen e operatorit fitues në mënyrë jo objektive.
- Rekomandimi 5** Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj se po respektohet ndarja e detyrave në pajtim me udhëzuesin operativ të prokurimit dhe të analizojë përse kjo kërkesë nuk është zbatuar konform rregullës së prokurimit, dhe të parandalojë rastet e tilla.

Çështja 6 - Përdorimi i shpeshtë i procedurës së negociuar pa publikim

- E gjetura** Nga 93 kontratat e nënshkruara në 28 prej tyre ishte përdorur procedura e negociuar pa publikim. Vlera e kontratave me këtë procedurë ishte 1,347,602€ apo 52% e totalit të kontratave. Kjo procedure ishte aplikuar kryesisht për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme por kishte raste edhe për zgjedhje të rregullta. Tenderi për “Furnizim me UV sprej për zgjedhjet Lokale 2017” i paraparë që të inicohet në mars 2017 me procedurë të hapur në fund kishte përfunduar me lidhje të kontratës me vlerë 44,400€ me procedurë të negociuar.
- Ky tender fillimisht ishte zhvilluar me procedurë të hapur, mirëpo ishte anuluar me 27/06/2017, pasi nuk kishte operatorë të përgjegjshëm. Arsyeja e anulimit ishte mospërmbushja e kriterit që “UV sprej të ketë kapakun e pahapshëm apo të siguruar”. Në procesin e tenderimit me procedurë të negociuar ky kriter ishte hequr.
- Rreziku** Përdorimi i procedurës së negociuar edhe për zgjedhjet e rregullta duke anashkaluar procedurat konkurruese, ndikon në dekurajimin e konkurrencës dhe rritë rrezikun që furnizimet të jenë mbi çmimin e tregut si rezultat i kufizimeve.
- Rekomandimi 6** Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj aplikimin e procedurave që ofrojnë konkurrencë dhe ju japin mundësinë e ofertimit të gjithë operatorëve të interesuar me qëllim që shërbime/furnizimet të merren me kosto sa më të ulët për të marrë vlerën për paranë e shpenzuar.

Çështja 7 – Urdhër blerjet dhe aneks kontrata janë më të larta se që lejohen

E gjetura

Në procesin e prokurimi kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Rregulla financiare 01/2013, në nenin 17 përcakton qartë se urdhër blerja krijohet dhe përgatitet nga ana e organizatës buxhetore pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata, që nënkupton se urdhër blerja nuk mund të krijohet përtej vlerës së kontratës. Në katër raste kemi vërejtur se urdhër blerjet ishin mbi vlerën e kontratës. Vlera e urdhër blerjeve ishte për 185,127€ më e lartë se vlera kontraktuale; dhe
- Kontrata bazë për “Furnizim me Uv Sprej për Zgjedhjet Lokale 2017” ishte me vlerë prej 44,400€. KQZ kishte lidhur një aneks kontratë në vlerë 4,856€, duke tejkaluar për 416€, 10% të vlerës së kontratës bazë.

Rreziku

Krijimi i urdhër blerjeve mbi vlerën e kontratës rritë rrezikun që porositë e mallit jashtë kontratës të furnizohen e pranohen dhe të krijohen obligime financiare përtej vlerës së kontratës. Kjo mund të ndikojë që mjetet të bllokohen dhe të mbesin të pashfrytëzuara për blerje tjera.

Tejkalimi i 10% të kontratës bazë, është në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Rekomandimi 7

Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj se menaxhimi i proceseve të prokurimit është në pajtim me legjislacionin dhe të ndërmer veprime konkrete në parandalimin e krijimit të urdhër blerjeve dhe aneks kontratave përtej limiteve të lejuara. Një monitorim i vazhdueshëm i menaxhimit të proceseve të prokurimit është i domosdoshëm nga menaxhmenti.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 4,200,000€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 4,196,859€. Ato kanë të bëjnë me përkrahje të partive politike për financimin e aktiviteteve të rregullta të partive politike, punën e grupeve parlamentare dhe aktiviteteve parazgjedhore dhe zgjedhore.

Mjetet u ndahen partive politike në bazë të numrit të ulëseve në Kuvend. Ato transferohen në periudha tremujore pas një raporti bankar dhe raporti financiar, si dhe grupeve parlamentare për mbështetje financiare për aktivitete politike u paguhen shpenzimet 10% e ndarjes së mjeteve për subjektin politik.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 144,801€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 114,652€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të TI-së, softuer dhe harduer.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV dhe regjistrave kontabël vlera neto e pasurive kapitale ishte 75,280€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale ishte 301,808€ dhe stoqet ishin 7,070€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës financiare Nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja 8 - Dobësi në menaxhimin e pasurive

E gjetura Në menaxhimin e pasurive kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Regjistri kontabël i pasurive nuk ishte i plotë, pasi që shpenzimet kapitale dhe jokapitale në shumë 65,970€⁶, nuk ishin të regjistruara në regjistra kontabël përkatës;
- Sistemi e-pasuria nuk ishte duke e kalkuluar zhvlerësimin në përputhje me normat e përcaktuara. Kjo është identifikuar në pesë raste (laptop të blerë në vitin 2014; fotokopje 2012 dhe multipad 2013) me vlerë fillestare 2,798€, të cilat sipas normave të zhvlerësimit do të duhej të figuronin me vlerën zero, derisa vlera e tyre ishte prezantuar gabimisht 1,831€;
- Rregullorja për menaxhimin e pasurive kërkon që raporti i inventarizimit të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që organizata të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jo financiare. Komisioni kishte kryer me kohë inventarizimin, mirëpo nuk kishte harmonizuar gjendjen e inventarizuar me regjistrat e pasurive jo financiare; dhe

⁶ Mbi 1,000€ ishin 63,896€ dhe nën 1,000€ ishin 2,074€.

- Në regjistrin e pasurive jo kapitale laptopi i blerë në vitin 2016 me numër serik (SYB06790877), nuk ndodhej në organizatë. Sipas pohimeve të KQZ-së, anëtari i KQZ-së pas largimit nga institucioni nuk kishte kthyer laptopin. Pas identifikimit nga auditimi KQZ kishte intervenuar dhe ky laptop ishte kthyer në organizatë.

Rreziku

Mangësitë e evidentuara në regjistrimin e pasurive, zhvlerësimin e tyre dhe mos harmonizimi i regjistrave me gjendjen e dalë nga inventarizimi, pasqyrojnë dobësi në menaxhimin e pasurive. Këto mangësi ndikojnë në mbivlerësim apo nënvlerësim të pasurive në PFV, e që kjo rritë rrezikun që pasuritë t'i ekspozohen rrezikut të humbjes apo keq menaxhimit.

Rekomandimi 8

Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj një mbikëqyrje aktive ndaj personelit që në një mënyrë apo tjetër merren me menaxhimin e pasurive për eliminimin e mangësive si në regjistrimin e pasurive ashtu edhe në zhvlerësimin e tyre, me qëllim të raportimit të saktë të vlerës së pasurive. Po ashtu, raporti i inventarizimit duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

3.9 Të arkëtueshmet

Vlera e Llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2017 sipas dëshmive të KQZ-së ishte 22,653€ të cilat nuk ishin të paraqitura në PFV. Prej tyre 1,350€ ishin gjopa të shqiptuara ndaj subjekteve politike gjatë zgjedhjeve të vitit 2017, të bartura nga vitet paraprake 3,260€ për vitin 2016; 12,000€ për vitin 2015 dhe 6,043€ për vitin 2014.

Subjektet politike nuk ishin të rregullta në pagesën e gjobave të tyre. Siç vërehet të arkëtueshmet kryesore i takojnë viteve paraprake e mos inkasimi i tyre është edhe pasojë e shuarjes së partive politike. KQZ si mekanizëm për inkasimin e tyre po e përdor momentin e kërkesës së subjekteve politike për certifikim në zgjedhje duke mos i certifikuar pa e shlyer borxhin. KQZ nuk kishte ndonjë rast që ka inkasuar borxhin përmes përmbaruesit privat. Të arkëtueshmet nuk ishin shpalosur në PFV-të dhe këtë çështje ne e kemi shtjelluar te nënkapitulli 2.2.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 144,089€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Këto obligime kishin të bënin kryesisht për pagesat e stafit jo permanent të angazhuar gjatë procesit zgjedhor, të cilat për shkak të gabimeve në sistem, thesari i kishte kthyer këto pagesa dhe përmbyllja e vitit fiskal ka pamundësuar ekzekutimin e tyre.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara.

Detyrimet kontingjente të paraqitura në PFV janë 234,783€. Pjesa më e madhe e këtyre detyrimeve kontingjente në shumë prej 130,174€, ishte si pasojë e tejkalimeve të kontratave. Kjo ka ndodhë që pas pranimit të mallit KQZ-ja, ka refuzuar ta paguajë mallin e pranuar dhe operatorët kishin dërguar lëndët për përmbarim tek përmbaruesit privat. Kjo vlerë e madhe e detyrimeve kontingjente, mund të sjellë në vështirësi financiare buxhetin e vitit 2018. Kjo çështje ka ndikuar që të theksojmë opinionin dhe është elaboruar më gjerësisht te kapitulli i opinionit 2.1 - (Theksimi i çështjes).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e KQZ-së për vitin 2016 ka rezultuar me 13 rekomandime. Prej tyre tetë janë zbatuar plotësisht, tre janë në proces dhe dy nuk janë zbatuar. KQZ-ja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Kurse raporti ynë i Auditimit për vitin 2015 ka rezultuar me 12 rekomandime, prej të cilave tetë rekomandime ishin bartur për tu zbatuar në 2017. Nga rekomandimet e vitit 2015, tre janë zbatuar, katër janë në proces të zbatimit dhe një nuk është zbatuar në lidhje me zhvlerësimin e pasurive jo kapitale.

Çështja 9 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** KQZ ka bërë një progres në adresimin e rekomandimeve, megjithatë një numër i rekomandimeve nuk janë adresuar plotësisht. Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me fushën e qeverisjes, kategorinë e pagave dhe mëditjeve, dhe menaxhimin e pasurive.
- Rreziku** Mos adresimi i plotë i rekomandimeve rrit rrezikun e përsëritjes së mangësive të njëjta, dhe ndikon që kontrollet e brendshme dhe sistemet kryesore financiare të jenë në vazhdimësi jo efikase për të përmbushur objektivat e përcaktuara.
- Rekomandimi 9** Kryetarja e KQZ-së duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor me stafin përgjegjës për zbatimin e tyre, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Menaxhmenti duhet të ndërmarrë veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura dhe zbatimi duhet të monitorohet në vazhdimësi.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KQZ-ja ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vetëvlerësimin por ka nevojë të përfshijë një vlerësim më kritik ndaj arritjes së rezultateve. Krahasuar me vitet paraprake KQZ përkundër sfidave në organizimin e dy palë zgjedhjeve ka shënuar një progres në menaxhimin e proceseve dhe qeverisjen e organizatës. Përmirësime kanë ndodhur sa i përket rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe vendimi i marrë për pagesat e stafit gjatë procesit zgjedhor.

Megjithatë, ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda KQZ-së veçanërisht në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe me mungesën e regjistrit të rreziqeve. Mbetet sfida përmirësimi i këtyre dy komponentëve sa i përket qeverisjes në vitin 2018.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor, që është Drejtor i NjAB-së. NjAB në Planin Vjetor për vitin 2017, kishte planifikuar katër auditime të rregullta. Plani vjetor i punës ishte hartuar në përputhje me planin strategjik, ku ishin përcaktuar fushat për auditim për vitin 2017. Plani ishte realizuar në tërësi, ku fushëveprimi i auditimit ishin aktivitetet e vitit 2016 dhe 2017.

Raportet e auditimit përmbajnë konkluzione dhe rekomandime të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm. Njësitë e audituara kishin hartuar planet për zbatimin e rekomandimeve dhe zbatimi i tyre ishte në proces. Gjithashtu, NjAB ka dorëzuar raporte tremujore për aktivitetet e saj në NjQHAB në MF.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime të rregullta dhe kishin shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Procesi i raportimit të brendshëm në KQZ funksionon sipas zingjirit llogaridhënës, sipas ligjit dhe strukturës organizative. Menaxhmenti mban takime sipas nevojave, ku diskutohen raportet dhe të gjitha aktivitetet e saj e ku në disa takime mbahen edhe procesverbale. Viti 2017 ishte vit sfidues për KQZ-në për shkak të volumit të madh të punëve gjatë proceseve zgjedhore (zgjedhje të jashtëzakonshme, zgjedhje lokale dhe balotazhe).

Çështja 10 - Dobësi në menaxhimin e rrezikut

E gjetura KQZ nuk ka hartuar regjistrin e rreziqeve siç kërkohet me rregullat e MFK-së, përkundër faktit që kishte bërë përpjekje për të vepruar në këtë drejtim. Menaxhmenti kishte filluar me identifikimin e rreziqeve dhe për këtë kishte marrë mbështetje nga IFES⁷ në përpilimin e regjistrit të rreziqeve, e ku në mars të vitit 2018 ishte caktuar një takim për shqyrtimin e draft raportit të vlerësimit të rreziqeve dhe planit për menaxhimin e rreziqeve.

Rreziku Mungesa e finalizimit të listës së rreziqeve dhe menaxhimit efektiv të tij do të pamundësojë reagimin me kohë ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet organizata, qofshin ato nga mjedisi i brendshëm apo i jashtëm. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar rreziqet e tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi 10 Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj përsheptimin e procesit në finalizimin e regjistrit të rreziqeve dhe të filloj menaxhimi i tyre. Po ashtu, pas hartimit të rreziqeve duhet të sigurohet delegimi i përgjegjësisë së drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut nëpër sektorët përkatës si dhe të sigurojë monitorim efektiv për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

⁷ International Foundation for Electoral Systems

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga dy vitet paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë qartë zyrtarët përgjegjës dhe afatet kohore për zbatim.		Me gjithë progresin e arritur në disa fusha, një pjesë e rekomandimeve nuk janë zbatuar.	
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se është duke u zbatuar një rishikim i vlerësimeve të dhëna në pyetësorin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë aktive.		Është plotësuar pyetësori i vetvlerësimit, megjithatë nevojitet një vlerësim më kritik pasi që vlerësimet e bëra nuk mbulohehim me dëshmitë e duhura.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek zyrtarët përgjegjës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.		Janë identifikuar rreziqet në nivel të departamenteve, mirëpo ende nuk është finalizuar lista e konsoliduar e rreziqeve.	
2.5.2 Aranzhimet e llogaridhënies dhe raportimi menaxherial	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se organizimi i brendshëm i sekretariatit të KQZ-së bëhet konform strukturës organizative të përcaktuar me Rregullorën aktuale. Gjithashtu të bëhet një rishikim i rregullimeve ekzistuese të delegimit të përgjegjësive dhe llogaridhënies. Në rastet kur detyrat e KE ushtrohen përkohësisht nga ndonjë zyrtarë tjetër, delegimi i përgjegjësive duhet të evidentohet me shkrim dhe të dhënat të mbahen në Planin e delegimeve të MF-së.	Po		

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetarja e KQZ-së të sigurojë se procedurat e rekrutimit për plotësimin e pozitave të lira fillojnë me kohë, dhe se për pozitat e udhëhequra me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore.		Pozitat janë plotësuar me vendim pa zhvilluar ndonjë procedurë konkurruese.	
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetarja të sigurojë se pasuritë evidentohen me barkode dhe se aplikohen normat përkatëse të zhvlerësimit për pasurinë e pa zhvlerësuar.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetarja e KQZ-së të sigurojë se automjetet zyrtare shfrytëzohen dhe menaxhohen në pajtim me procedurat dhe rregullat ligjore.	Po		
3.7.2 Trajtimi i borxheve	Kryetarja e KQZ-së të sigurohet se detyrimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor. Nëse për ndonjë arsye borxhet mbesin të papaguara, ato duhet të raportohen me kohë në MF/Thesar.	Po		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprime shtesë me qëllim të zbatimit të plotë të rekomandimeve të AP-së sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme dhe aty ku rekomandimet janë përsëritur. Një monitorim sistematik nga ana e menaxhmentit është i nevojshëm për të siguruar zbatim efektiv të rekomandimeve dhe brenda afateve të përcaktuara.		Me gjithë progresin e arritur në disa fusha, një pjesë e rekomandimeve nuk është zbatuar ende.	

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm efektiv për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për ta siguruar dokumentacionin mbështetës.		Një pjesë e rekomandimit në lidhje me vetëvlerësimin është adresuar, mirëpo lista e rreziqeve ende nuk ishte finalizuar.	
2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se organizimi i brendshëm i sekretariatit të KQZ-së bëhet konform strukturës organizative të përcaktuar me Rregulloren aktuale dhe në pajtim me kërkesat ligjore.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë që angazhimet dhe pagesat e stafit për punë jashtë orarit të bëhen në përputhje me normat e lejuara ligjore.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetarja e KQZ-së, të ndërmarrë hapa konkret që të sigurojë që pozitat e mbuluara me UD të plotësohen me staf me kontratë të rregullt, përmes një konkurrence të hapur.		Pozitat janë plotësuar me vendim pa zhvilluar ndonjë procedurë konkurruese.	
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se janë përmbushur kërkesat për plotësimin e përshkrimit të vendit të punës për çdo pozitë brenda institucionit.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se çështja e pagesës së stafit të angazhuar për procese zgjedhore, të rregullohet me vendim të veçantë, i cili është valid për zgjedhjet përkatëse.	Po		
3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se stafi përgjegjës respekton hapat e përcaktuar ligjor mbi procesin e shpenzimeve, përgatitja e urdhër blerjeve bëhet vetëm pas nënshkrimit të kontratës dhe faturat e pranuar paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Po		

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se merren masa për aplikimin e normave të përcaktuara të zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale në mënyrë që menaxhmenti të ketë informata të plota mbi pasurinë që e posedon.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se janë ndërmarrë hapat konkret mbi zbatimin e rekomandimit për tjetërsimin e pasurive të vlerësuara si të dëmtuara dhe të panevojshme për organizatën. Gjithashtu të sigurojë se komisioni i caktuar për inventarizim njoftohet mbi përgjegjësitë për kryerjen efektive të këtij procesi, duke krahasuar gjendjen aktuale të pasurive me regjistrat e pasurive jo financiare, dhe përgatitjen e një raporti të plotë mbi vërtetimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive.			Nuk janë marrë masa.
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetarja e KQZ-së, të sigurojë se më tutje veprohet sipas kërkesës së rregullës financiare dhe në rastin e pranimit mallit formohet komisioni i pranimit.	Po		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetarja e KQZ-së, të rishikojë udhëzimet e brendshme dhe të sigurojë se ato janë në përputhje Udhëzimet e përgjithshme të Qeverisë, të sigurojë se kërkesat dhe raportimi mbi përdorimin e automjeteve janë të plota dhe të rregullta.	Po		
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetarja e KQZ-së të sigurohet që obligimet paguhen brenda afatit ligjor, ndërsa faturat e papaguara raportohen në Thesar në pajtueshmëri me Rregullën financiare 02/2013 për raportimin e obligimeve.	Po		

Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të **Komisionit Qendror Zgjedhor**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pas diskutimeve, përgjithësisht jemi pajtuar me të gjeturat dhe rekomandimet dhe tashmë nuk kemi komente për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, dhe pas miratimit në KQZ, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Enis Halimi, kryeshef ekzekutiv

21 qershor 2018, Prishtinë,